

AKTI I THEMELIMIT
TË SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“Haré & Co” shpk

Sot, më datën *08/10/2024* mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe në legjislacionin shqiptar në fuqi personat e mëposhtëm:

1. Z. Ervin Xhaferaj, me numër personal identifikimi **L73MKK9W4**, shtetas gjerman, mbajtës i dokumentit të Lejes së Qëndrimit me numër *I33423008B* lindur më 23/04/1983, në Tiranë dhe banues në Tiranë, Shqipëri.
2. Znj. Rea Xhillari, me numër personal **J05218049I**, shtetase shqiptare, lindur më 18/02/1990, në Tiranë dhe banuese në Tiranë, Shqipëri.

me cilësinë e "Ortakut" vendosin të themelojnë një shoqëri në tregtare me përgjegjësi të kufizuar sipas kushteve të mëposhteme.

Neni 1
Emërtimi dhe Themelimi

Emri i shoqërisë është **“Haré & Co” shpk**, më poshtë e quajtur “Shoqëria”.
Shoqëria themelohet në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar.
Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Neni 2
Selia

Shoqëria do të ketë Selinë e saj në Adresën: **Rruga “Themistokli Gërmenji”, Zona Kadastrale 8160 Nr i pasurisë 2/119-N, Njësia Administrative Nr 2, Tiranë.**

Me vendim të organit administrativ, shoqëria mund të zhvendoset, të hapë degë ose zyra përfaqësimi brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë.

Neni 3
Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj me afat të pakufizuar. Ky afat mund të zgjatet ose të shkurtohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.



Neni 4
Objekti

Shoqëria Haré & Co shpk do të ketë si objekt:

- Bar-restorant, importues i produkteve ushqimore dhe shitje me pakicë i produkteve ushqimore. Importim dhe tregtim me shumice dhe pakicë të pijeve alkoolike.

Neni 5
Degët

Shoqëria ushtron aktivitetin e saj mbi bazë dege në qytete të tjera të vendit të cilat do të hapen pasi të ketë filluar aktiviteti i shoqërisë.

Neni 6
Ortakët

Kur shoqëria pushon veprimtarinë e saj, pasi shlyen të gjitha detyrimet që ka, pjesën e mbetur të kapitalit dhe të të ardhurave i përfitojnë ortakët e saj.

Ortakët themelues përballojnë humbjet e shoqërisë deri në kufirin e vlerës së derdhur në formimin e kapitalit themeltar. Kapitali bazë mund të rritet nga fitimi në natyrë, ose kontribute të ortakut/ve të shoqërisë.

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 10'000 (dhjetë mijë) Lekë dhe është i ndarë në 2 (dy) kuota. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

1. Ortaku themelues Z. Ervin Xhaferaj, zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme që përben 50% (pesëdhjetë) të kapitalit themeltar të shoqërisë.
2. Ortaku themelues Znj. Rea Xhillari, zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme që përben 50% (pesëdhjetë) të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Neni 7
Administratori

Veprimtaria operative e shoqërisë drejtohet nga Administratori i saj i Përgjithshëm. Në shoqërinë **Haré & Co shpk** Administrator i shoqërisë do të jetë: Z. Ervin Xhaferaj, atësia Namik, shtetas i huaj, identifikuar me numër personal identifikimi L73MKK9W4, i datëlindjes 23/04/1983, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë.

Administratori emërohet për një kohëzgjatje prej 5 (pesë) vjetësh financiare me përjashtim të rasteve të dorëheqjes ose shkarkimit të parakohshëm me të drejtë ri-emërimi. Administratori ka të gjitha kompetencat për të kryer të gjitha veprimet me interes të shoqërisë dhe në emër të saj nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e veprimtarisë së shoqërisë me

përgjashtim të atyre kompetencave që ligji nuk i njeh. Administratori është përgjegjës individualisht ndaj shoqërisë apo të tretëve për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit apo për faj të tij gjatë administrimit të shoqërisë.


Neni 8
Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë akt themelimi dhe dispozitat e legjislationit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

ORTAKËT
E SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"Haré & Co shpk" shpk

ERVIN XHAFERAJ



(Emër, Mbiemër, Nënshkrimi)

REA XHILLARI



(Emër, Mbiemër, Nënshkrimi)